

## Mësimdhënia e Bazuar në Projekte

Tipi i Programit: Themelor

Historiku i Programit

Mësimi i bazuar në projekte është një ndër metodat mësimore të rekomnuara nga reforma arsimore. Është program i cili është dizajnuar specifikisht për konkretizimin e mësimit teorik, dhe ndërlidhjes së fushave/lëndëve të ndryshme mësimore. KEC ka hartuar dhe pilotuar këtë program trajnues në kuadër të vitit të parët të programit ASSET, me dy shkolla të saja partnere. Në fillim të vitit të dytë të ASSET-it, materiali i programit të këtij kursi është rishikuar, plotësuar dhe përgatitur për proces të akreditimit. Përmes këtij kursi pritet që mësimdhënësit të aftësohen që të ndihmojnë nxënësit e tyre në arritjen e kompetencave mësimore, e në veçanti do të zhvillohen shkathtësitë, si: të menduarit kritik, puna ekipore, ndërgjegjëshmeria dhe kembengulesia, zgjedhja e problemeve, kreativitetit, shkathtësi hulumtuese dhe ndërmarrëse. Përvet të tjerash pjesëmarrësit janë aftësuar për përdorimin e metodave për vlerësimin e vazhdueshëm të projekteve.

Deri më tani përmes programit ASSET janë certifikuar 521 mësimdhënës të gjimnazeve partnere. Në vitet e ardhshme pritet që të gjithë mësimdhënësit të trajnohen me këtë program, por kjo varet nga Ministria e arsimit, DKA-të dhe shkollat.

Qëllimet e programit:

Të kuptuarit e procesit të mësimdhënies së bazuar në projekte si një metodë mësimdhënies që angazhon nxënësit për të fituar kompetenca për jetë përmes një procesi më të gjatë, kërkues dhe kreativ, të ndërtuar në bazë të sfidave dhe pyetjeve autentike, që çojnë në arritjen e qëllimeve të planifikuara me kujdes.

Pjesëmarrësit në këtë program trajnues do të pajisen me rezultatet si në vijim:

- Të zhvillojnë të kuptuarit për MBP
- Të reflektojnë mbi praktikën e mësimdhënies dhe përshtatjes së MPB me to
- Të zhvillojnë njohuri bazë tek nxënësit dhe të rrisin interesimin e tyre për të nxënësit ndër-lëndor, në mënyrë që të jenë në gjendje të përballen me ndryshimet dhe sfidat e botës moderne në jetë dhe punë në të ardhmen
- Të forcojnë aftësitë e nxënësve për t'i integruar dhe përdorur njohuritë dhe shkathtësitë e tyre, të ushqejmë kreativitetin e tyre, aftësitë bashkëpunuese dhe aftësitë në zgjidhjen e problemeve, si dhe të shtyjmë përpara idetë e tyre inovative, ashtu siç kërkohet në shekullin e 21-të.
- Të forcojnë kapacitetin profesional dhe bashkëpunues në mesin e mësimdhënësve si dhe partneritetin me akterët në komunitet
- Të përkrahim nxënësit talent dhe të krijojmë ekspertë në fusha ndër-lëndore në mënyrë që të mund të kontribuojmë në zhvillimin e shoqërisë

### Përmbajtja:

Ky program është dizajnuar duke marr parasysh mësimdhënien e bazuar në projekte si një strategji efikase që mundëson përmbushjen e rezultateve të të nxënësve për kompetencat e Kornizës së Kurrikulës së Kosovës. Programi i adreson edhe parimet e kornizës kurrikulare si pjesë e punës praktike gjatë realizimit të projekteve. Përmes mësimdhënies së bazuar në projekte, nxënësit do të jenë në gjendje të planifikojnë dhe të realizojnë projekte për të rritur njohuritë akademike dhe shkathtësitë për të bashkëpunuar, menaxhuar, udhëhequr, analizuar, komunikuar dhe për të reflektuar.

Pjesë e realizimit të programit janë elementet bazë të mësimdhënies të bazuar në projekte, krijimi i mjedisit bashkëpunues, dizajni i projekteve efektive dhe menaxhimi i projekteve në shkollë.

### Grupi i synuar

Te gjithë mësimdhënësit e shkollave të mesme të larta, Gjimnazeve dhe shkollave profesionale, respektivisht klasave X, XI, dhe XII. Sipas kurrikulës bërthamë të këtij niveli të gjithë mësimdhënësit do të duhej të kenë njohuri për Mësimdhënien e Bazuar në Projekte, prandaj ky program synon të përfshijë të gjithë mësimdhënësit në mardhenie pune në arsimin e mesëm të lartë. Numri i pjesëmarrësve nuk është i kufizuar, por do të synohet që të gjithë mësimdhënësit të kalojnë nëpër këtë trajnim.

### Forma e organizimit /Kohëzgjatja

Pjesëmarrësit e identifikuar paraprakisht do të marrin pjesë në punëtorin 3 ditore, secila ditë me nga 4 sesione 90 minutesh, të moderuara nga fasilituesit profesional. Pas dy ditëve të para, secili pjesëmarrës do të kthehet në shkollë dhe të planifikojnë mësimin në bazë të integritit të kurrikulave të disa lëndëve/ fushave mësimore. Planifikojnë projekt mësimor, të lidhur me rezultatet konkrete të pritura nga lënda e tyre, por në bashkëpunim të ngushtë me lëndët tjera (kolegët tjerë) të përfshira në projekt. Projekti realizohet sipas dinamikës së paraparë me periudhën mësimore. Gjatë tërë këtij procesi mësimdhënësit mentorohen nga fasilituesit e kursit, dhe përkrahen sipas nevojës. Poashtu, gjatë këtij procesi nxënësit vlerësohen edhe për rezultatet mësimore, siç janë të pritura për periudhat mësimore, dhe për shkathtësitë e buta.

Ky proces kompleks koordinohet prej koordinatorit të cilësisë në shkollë dhe departamenteve profesionale të fushave mësimore.

Në ditën e tretë të trajnimit, e cila realizohet disa javë pas ditës së dytë, mësimdhënësit prezantojnë projektet e realizuara.

### Vlerësimi/Certifikimi

Në fund të këtij trajnimi pjesëmarrësit mësimdhënës do të certifikohen duke u kredituar me gjithsej 24 orë trajnimi (6 orë x 3 ditë= 18 orë; plus 6 orë të kalkuluara për implementimin e aktiviteteve në shkollë gjatë procesit të reflektimit /mentorimit).

Kriteret për certifikim janë:

- 90% pjesëmarrje në trajnim dhe në takimet reflektuese me mentor;
- Prezantimi i produktit final të realizuar me nxënësit duke dokumentuar të gjithë hapat e realizimit të projektit përmes mësimdhënies së bazuar në projekte sipas udhëzimeve.

- Prezentimi me gojë para fascilitoreve dhe pjesmarresve të trajnimit.

#### Materialet e trajnimit

- Udhëzuesi për fasilitues të programit trajnues së bashku me fletat e punës;
- Sllajdet në Power Point dhe Video prezentimet;
- Doracaku për mësime të gjimnazeve